



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:264916
Datë: 24.09.2021
Numri i dokumentit: 02206775

A.nr.2723/2018

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Hajriz Hoti, në konfliktin administrativ të paditësve, M.K. dhe G.S. nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson, V.A., avokat ne Graçanica, kundër të paditurës, Agjencia Kadastrale e Kosovës në Prishtinë, për shkak të anulimit të aktvendimit, jashtë seance më dt.22.09.2021, merr këtë,

A K T V E N D I M

I. Aprovohet kërkesëpadija e paditësit, M.K. dhe G.S. nga Prizreni, anulohet aktvendimit i të paditurës, Agjencia Kadastrale e Kosovës, me nr.03058/16 dhe 031103/16 të dt.26.09.2016, dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te e paditura.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative, prani të autorizuarit të paditësve, e në mungesë të palës së paditur të thirrur në mënyrë të rregullt.

I autorizuari i paditësve, V.A. në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë të gjitha të shkruarave në padi dhe gjithashtu në kërkesëpadi, duke theksuar se palët e kundërshton aktvendimin e AKK-së nr.031058/16 dhe 031103/16 të dt.26.09.2016. procedura e paditësve për regjistrimin e paluajtshmërisë është bazuar në aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Komunale në Prizren, c.nr. 546/98 dt.08.10.1998. Duke kërkuar nga AKK që të evidentohet pasuria të cilën paditësit e kanë trashëguar me aktgjykim. Paditësit janë detyruar të përmirësojnë një gabim teknik në pikëpamje të sipërfaqes dhe paditësit në afatin kohor me aktvendim të Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.546/98, të dt.13.01.2016 kanë përmirësuar gabimin e lartcekur në aktgjykim në të cilat janë plotësuar kushtet për zgjidhjen e kërkesës së tyre në këtë kontest administrativ. Kadastra komunale në Prizren e ka refuzuar kërkesën të M.K. dhe të tjerëve që të evidentohet pasuria e tyre në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm të gjykatës. Në atë aktvendim të shkallës së parë të organit administrativ M.K. etj kanë ushtruar ankese në AKK. Organi i shkallës së dytë duke marr aktvendim për këtë kontest as pak nuk e ka shqyrtuar të thënat dhe të shkruarat në ankesë, mirëpo ka refuzuar ankesën e M.K. etj si të pabazuar, duke vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë të Kadastrit Komunal të Prizrenit me nr.07/027/36B të dt.19.07.2016. Organi i shkallës së dytë duke marr aktvendim të dt.26.09.2016, e ka lënduar të drejtën materiale po ashtu është marrë edhe në kundërshtim edhe

me nenin 166 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, në të cilin përcaktohet që aktgjykimi i cili nuk mundet të shfuqizohet është përfundimtar, po ashtu edhe në kundërshtim dhe me nenin 167 paragrafit 1 të LPK-së ku përcaktohet se vendimi përfundimtar prodhon rezultat ndërmjet palëve në procedurë, po ashtu edhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative nenin 85, sepse e njëjti nuk përmban arsyetimin e provave në bazë të cilave organi i paditur ka vendosur. Kështu veprimet e shkallës së dytë janë në kundërshtim edhe sipas Kushtetues se Kosovës neni 36 dhe protokollit të parë të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut. I ka Propozuar Gjykatës që kërkesëpadia e paditësve të aprovohet në tërësi si e bazuar si në petitumin e padisë.

E paditura përmes përgjigjes në padi ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjegjes në padi të dt.10.11.2020, duke i propozuar gjykatës që padia dhe kërkesëpadia e paditësve të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.22.09.2021, ka bërë administrimin e provave që gjenden në shkresa të lëndës dhe atë: aktvendimi i të paditurës i dt.26.09.2016, aktvendimi i lëshuar nga Komuna e Prizrenit i dt.19.07.2016, aktgjykimi i lëshuar nga Gjykata Komunale në Prizren C.nr.546/98 i dt.08.10.1998, aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.546/98, i dt.13.01.2016, konkluzioni i lëshuar nga Komuna e Prizrenit i dt.27.06.2013, si dhe përgjigja e AKP-së për të autorizuarin e paditësit, S.V. avokat nga Prizreni i dt.08.06.2016.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të goditur me padi, në përputhje me nenin 43, 44 dhe 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar.

Me aktvendimin e të paditurës me nr.031058/16 dhe 031103/16 të dt.26.09.2016, të goditur me padi, është refuzuar si e pabazuar ankesa e dt.26.08.2016, e parashtruar nga M.K., kundër aktvendimit të Drejtorisë për Gjeodezi Kadastër të Komunës Prizrenit të dt.19.07.2017.

Paditësit, të pakënaqur me këtë aktvendim, me datë;15.11.2018, ushtron padi në këtë gjykatë, duke e kontestuar ligjshmërinë e të njëjtit.

Nga aktvendimi i kontestuar del se ai përmban të meta të tilla për shkak të te cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84 par.2 të këtij ligji është paraparë se “akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruar nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar”. Në nenin 85 të po të njëjtit ligj, parashikohet se “përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtat dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen çart dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit”.

Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i pa qartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e aktvendimit është dhënë një

formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se “Agjencia Kadastrale e Kosovës pas shqyrtimit të ankesës së palës dhe shkesave të lëndës, vërteton aktvendimin me nr.07-027-3856B, të dt.19.07.2017 të nxjerrë nga Drejtoria për Kadastër e KK Prizren, pasi rezulton se pala nuk ka ofruar ndonjë prove të re e cila do të kishte ndikuar në ndryshimin e aktvendimit të atakuar të organit të shkallës së parë. Në këtë rast AKK-ja vendosë në mbështetje të nenit 136 pika (a) të Ligjit për Procedurën Administrative nr.02/L-28.”.

Nga provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor dhe atë, aktgjykimin e lëshuar nga Gjykata Komunale në Prizren nën shenjë C.nr.456/98, të dt..08.10.1998, aktgjykim ky i formës së prerë dhe përmirësimi i këtij aktgjykimi me aktvendimin e Gjykatës Komunale të Prizrenit C.nr.456/98 të dt.13.01.2016, Gjykata vëren së paditësit e kanë titullin juridik për pronën të cilën kërkojnë ta regjistrojnë në regjistrat komunal kadastral të Komunës së Prizrenit.

Në këtë kuptim, Gjykata vëren se gjendja faktike nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë në organin e paditur, po ashtu edhe si rezultati mos vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike nuk është zbatuar drejtë ligji material, ngase sipas vlerësimit të gjykatës paditësi, e ka titullin juridik për regjistrimin e paluajtshmerisë së kërkuar në librat publik kadastral sipas kontratës C.nr.456/98, të dt.08.10.1998, dhe përmirësimi i këtij aktgjykimi me aktvendimin e Gjykatës Komunale të Prizrenit C.nr.456/98 të dt.13.01.2016, në këtë drejtim Gjykata vlerëson se, paditësit i kanë plotësuar kërkesat Ligji për Themelimin e Regjistratit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, nr.2002/5, nenit 3.2 të të njëjtit, i cili përcakton se “parashtruesi që kërkon regjistrimin e të Drejtave të Pronave së Paluajtshme, kërkesës duhet t’ia bashkëngjis dokumentacionin përkatës për të mbështetur të drejtën e pronës së paluajtshme siç kërkohet me ligjin në fuqi, të përcaktuar me nenin 3.7 të këtij Ligji. Dhe se, “Të drejtat mbi pronën e paluajtshme që parashihen sipas nenit 2 të Ligjit, regjistrohen në bazë të: vendimit të plotfuqishëm të gjykatës, vendimit të organit administrativ shtetëror, kontratës për bartjen e së drejtës së pronës së paluajtshme të vërtetuar nga organi kompetent, vendimit apo kontratës për privatizim të lëshuara nga AKP, vendimit të komisionit për rindërtimi të Kadastrit, vendimit të komisionit për rregullimin e tokave dhe dokumenti tjetër që me ligje të veçanta parashihet regjistrimi i të drejtave pronësore”. Po ashtu edhe me Udhëzimin Administrativ nr.2004/3, nenit 5 të të njëjtit është përcaktuar se, “baza ligjore për regjistrim. Regjistrimi i një të drejte mbi pronën e paluajtshme mund të bazohet në një dokument valid nga një organ kompetent gjyqësor apo administrativ, vendim përfundimtar nga gjykata kompetente dhe me një transaksion ligjor, që përputhet me dispozitat e ligjit në fuqi”.

Në bazë të dispozitave të sipërcituara të Ligjit dhe Udhëzimit paditësit e kanë titullin juridik, përkatësisht aktgjykim përfundimtar të formës së prerë nga gjykata kompetente, për regjistrimin e paluajtshmerisë së kërkuar në librat publik kadastral komunal.

Gjykata, si rregull, konfliktin administrativ e vendos në bazë të gjendjes faktike, të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga aktvendimi i goditur në padi, nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike, dhe si rezultat i vërtetimit jo të drejtë të gjendjes faktike, gabimisht është zbatuar ligji material.

Të metat e cekura më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në afat prej tridhjetë 30 ditësh, në riprocedurë të veprojnë sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t’i mënjanoj të metat e cekura, të merr aktvendim të drejtë të bazuar në ligj.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 64 të Ligjit për Konfliktet Administrative, që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e të paditurës, të dhëna në padi, por të njëjtat pretendime Gjykata i vlerëson si të pa bazuar, për faktin se, paditësit e kanë titullin juridik për regjistrimin e pronës së kërkuar, duke u bazuar në Ligji për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, nr.2002/5 dhe Udhëzimin Administrativ nr.2004/3. Sipas vlerësimit të Gjykatës aktgjykimet e formës së prerë të Gjykatave janë dokumente valide, e të cilat janë të pa kontestueshme në kuptim të kësaj dispozitë të udhëzimit administrativ, dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe derisa nuk provohen në procedurë penale se aktgjykimi apo aktvendimi është nxjerrë si pasojë e kryerjes së veprës penale me aktgjykim të formës së prerë në procedurë penale, ato duhet të zbatohen pa i marrë parasysh pasojat e supozuara të cilat mund të shkaktojnë, në këtë rast AKP-së e cila ka pretendime pronësore në raport me ngastren kadastrale në të cilën paditësve i është njohur e drejta e pronësisë. Sipas vlerësimit të Gjykatës Agjencia Kosovare e Privatizimit mund të ushtroj padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për vërtetimin e pronësisë për ngastren kadastrale në të cilën paditësve i është njohur e drejta e pronësisë, por jo edhe të ndërmarr veprime me të cilat do ta pengonte ekzekutimin e aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës, si në rastin konkret.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna më lart, gjykata në kuptim të nenit 5, 6, 38, 43, 44 dhe 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

A.nr.2723/2018, dt.22.09.2021,

Zyrtar Ligjor
Fatlum Gashi

G j y q t a r
Hajriz Hoti

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate